

**VENDIM**  
**Nr.177, datë 9.3.2011**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.55, DATË 26.1.2011 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË**  
**TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2011, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 10 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr.55, datë 26.1.2011 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2011, në njësitë e qeverisjes qendrore, bëhet 1 241 vetë. Shtesa prej 95 punonjësish është e detajuar sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi të përballohen nga shpenzimet korente të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2011, të njësive të qeverisjes qendrore. Përgjashtimisht, për 17 punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit, efektet financiare përballohen vetëm nga të ardhurat e vetë institucionit.

3. Ngarkohet Ministria e Financave të miratojë me hollësi numrin e punonjësve, sipas lidhjes nr.2, brenda kriterëve të përcaktuara në vendimin nr.1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministritë dhe institucionet buxhetore”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e miratimit të tij.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**